Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0237
Data e Vendimit: 27.03.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenit 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 dhe nenit 64 të Rregullores Nr.002/2022 për Prokurim Publik pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik OE "Rojet E Nderit" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të sigurimit fizik për objektet e MPB-së" me numër të prokurimit 214-23-11803-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME", Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me 27/03/2023, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e jashtafatshme, ankesa e "Rojet E Nderit" SH.P.K. me nr. të protokollit 2024/0237, e datës 19/03/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Shërbime të sigurimit fizik për objektet e MPB-së" me numër të prokurimit 214-23-11803-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME".

II. Lejohet, autoritetit kontraktues – "MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME" që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të sigurimit fizik për objektet e MPB-së" me numër të prokurimit 214-23-11803-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

"MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME" në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 14.11.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime të sigurimit fizik për objektet e MPB-së" me numër të prokurimit 214-23-11803-2-1-

1, me datën 28.02.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me datë 04.03.2024 OE "Rojet E Nderit" SH.P.K. kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 07.03.2024 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të pa bazuar.

Operatori ekonomik i pakënaqur me vendimin e AK -"MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME"ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit, përmes sistemit e-prokurimit me datën 19.03.2024

- Administrimi dhe Vlerësimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Shërbime të sigurimit fizik për objektet e MPB-së" me numër të prokurimit 214-23-11803-2-1-1, në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK) "MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME", ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me datë 28.02.2024. Ndaj këtij njoftimi është paraqitur kërkesë për rishqyrtim nga operatori ekonomik ankues me datën 04.03.2024 ndërsa me datën 07.03.2024 AK ka refuzuar kërkesë për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Meqë AK - "MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME" me datën 07.03.2024 AK ka refuzuar kërkesë për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues, afati ligjor për të paraqitur ankesë në OSHP ka filluar të rrjedh nga data 08.03.2024 , respektivisht pala e pa kënaqur ka pasur te drejt te parashtroj ankesë brenda 10 ditëve.

Zyra për pranimin e ankesave pas pranimit të ankesës ka konstatuar se operatori ekonomik ankues OE "Rojet E Nderit" SH.P.K. ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 19.03.2024.

OE ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 2 të nenit 109 të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtroj ankesë në OSHP, pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK.

Neni 109 paragrafi 2 i LPP-së përcakton se *Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.*

Po ashtu, edhe neni 64.1 në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcaktohen se: *Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.*

-Përfundimi-

Konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 19.03.2024 nga OE "Rojet E Nderit" SH.P.K. për aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime të sigurimit fizik për objektet e MPB-së" me numër të prokurimit 214-23-11803-2-1-1 është e jashtafatshme sepse

ankuesi nuk ka parashtruar ankesën brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 109 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 64 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e jashtafatshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP. Po ashtu zyra për pranimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi për pagesën e tarifës me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP konform nenit 111 të LPP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **Rojet E Nderit SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: